ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: ........

Tiranë, 13 Prill 1939

Fort i dashur e i nderuar Im Ungj,

Mora dje me anën e z. Llambi Mano letrën bashkë me shumën e 100 frangave. Ju falem nderit dhe ju jam mirënjohës për këtë; Zoti na shpërbleftë me të mira të shumta. Që i kërkova telegrafisht, ish shkaku për ato dit të pasigurisë, se u-ndodha bosh (mbasi s'kishim marrë as rrogën) dhe ndodheshim në frikë të madhe, se s'dinim ç'do të bëhej; kaluam çaste agonie ato 2-3 dit, gjer sa u-shporrën hajdutët-zyrtarë dhe erdhën forcat italiane. Tashi ato të holla do t'i dërgoj për Violetën dhe nuk dua t'ju bezdis më për këto muaj.

Qetësia u-lë rregulluar tashi. Fillojmë një jetë të re, me ...shpresa të reja. Lajmet do t'i mësoni nga gazetat. Dje u-mblodh Asambleja (Ἐθνοσυνέλευσις); u-formua edhe Qeveria e re ndën z. Shevket Verlaci. Mikun z. Xhafer Ypi e kini tashi në Drejtësi, atje ku duhet për juve.

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

Une vashdoj, shyqyr Zotit, punën e mëparshme në Zyrën e Shtypit. Letrat m'i drejtoni vetëm mbi emrin t'em mjafton (Vasil Xhaçka, gazetar, Tiranë).

Zarfin t'uaj po e dërgoj tashi me z. Llambi, s'kisha si t'a dërgoj më parë pas ngjarjeve të papritura.

Tërë familja jemi mirë dhe ju puthim dorën e shenjte. Fëmija vashdojnë në shkollë si më parë. Pashkët s'i ndjejmë fare sivjet.

Tashi besoj se edhe Ingjot Kisi me shokë do t'i lërë budallallëkët që sjellin prapësi.

Dhiakut Theodhullo të fala të përzemërta, ashtu edhe z. V. Kondi.

A e muarte një letrën t'ime para Pashkë?-

Me nderime

Vasili

P. Sh. Po vë këtu edhe një letrë për Tetko-Petren.

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ